



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 17, 18 dhe 30 prill 2019.
2. Diskutimi në parim i projektligjit “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, propozuar nga një grup deputetësh (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fideli Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Besnik Baraj (zëvendësues).

Grupi i deputetëve propozues të projektligjit: Eglantina Gjermani, Elena Xhina, Vilma Bello, Besnik Baraj, Andrea Marto, Evis Kushi, Blerina Gjylameti, Klotilda Bushka, Elona Gjebrea.

Mungojnë:

Eneda Kapllani.

Të ftuar:

Redi Shtino – Zëvendësministër i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë,
Matilda Bulku – specialiste në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit,
Skënder Gjinushi – ekspert i ligjit,
Vasil Tole - ekspert i ligjit,
Lucian Brujan –përfaqësues nga Akademia Kombëtare e Gjermanisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi- Mirëmëngjesi të gjithëve!

Mbledhja e sotme e komisionit ka si rend dite diskutimin në parim të projektligjit “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, propozuar nga një grup deputetësh.

Kjo mbledhje do të ketë një ndryshim, sepse do të drejtohet nga kryetarja e re e komisionit, zonja Fatjona Dhimitri, e cila vjen si përfaqësuese e grupit të Partisë Demokratike.

Suksese në detyrën e re në drejtimin e komisionit, zonja Fatjona!

Në emër të kolegëve të mi premtojmë që do të jemi gjithmonë të gatshëm për të bashkëpunuar. Dua t’ju vë në dijeni se komisioni ka si nënkryetare Milvën, dhe sekretar zotin Fidel Ylli. Vendimet për kalendarin e veprimtarisë së komisionit do të kryhen në vazhdimësi nga ju si kryetare, unë si nënkryetare, dhe sekretari, zoti Fidel.

Edhe një herë ju uroj për drejtimin e komisionit dhe ju jap fjalën për të vazhduar punimet e komisionit.

Fatjona Dhimitri- Ju falënderoj, zonja Milva!

Në cilësinë e kryetares së komisionit, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe zotohem të zbatoj Rregulloren e Kuvendit, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në vijim të një bashkëpunimi të mire, për të garantuar kështu mbarëvajtjen e komisionit.

Së pari, do të fillojmë me miratimin e procesverbaleve të datave 17, 18 dhe 30 prill. A jeni dakord? Keni ndonjë vërejtje?

Miratohen.

Vijojmë me rendin e ditës, diskutimi në parim i projektligjit “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

Të ftuar nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë janë zoti Redi Shtino, zëvendësministër, znj. Matilda Bulku specialiste në sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit. Gjithashtu, të ftuar janë ekspertë të ligjit, zoti Skënder Gjinushi, zoti Vasil Tole dhe nga Akademia Kombëtare Gjermane, Lutsia Brujal.

Vijojmë me diskutimet. Fjalën e ka relatori i çështjes.

Eglantina Gjermani- Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Suksese në punën tuaj!

Të nderuar kolegë deputetë, në datën 3 prill të vitit 2019, një grup prej 14 deputetësh të Kuvendit, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, pedagogë dhe mësimdhënës në universitete të ndryshme të vendit, vendosëm të depozitojmë në Kuvend nismën ligjvënese për Akademinë e Shkencave. Nga pikëpamja formalo-ligjore këtë nismë e kemi propozuar duke u bazuar në nenin 81 të Kushtetutës, i cili parashikon se të drejtën e nismës ligjvënese e kanë edhe deputetët.

Nga pikëpamja procedurale nisma bazohet në Rregulloren e Kuvendit, konkretisht në nenin 68, i cili parashikon se projektligji duhet të shoqërohet nga një relacion shpjegues, të përmbajë objektiva që synohet të arrihen me miratimin e tij, si edhe të shprehë faturë financiare, nëse ka.

Ky projektligj, që përbëhet nga shkresa zyrtare me nënshkrimin e deputetëve nismëtarë, teksti dhe relacioni shpjegues të tij, u është nënshtruar rregullave të procedurës, si nga ana e paraqitjes, ashtu edhe duke u përfshirë në programin aktual të punës së Kuvendit dhe në kalendarin trijavor të punimeve të tij, për t'u trajtuar si punë në komisione, në përputhje me afatet që Rregullorja parashikon.

Referuar sa më lart, grupi i deputetëve nismëtarë më ka autorizuar që në emër të tyre të prezantoj këtë nismë para dy komisioneve të ngarkuara për shqyrtimin e saj, këtu në Komisionin e Edukimit dhe në Komisionin e Ligjeve.

Diskutimi për projektligjin për Akademinë e Shkencave është me rëndësi thelbësore jo vetëm për botën akademike, por edhe për mbarë shoqërinë, sa kohë që ky propozim ligjor përcakton bazën dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave, pjesës më elitare të kërkimit shkencor dhe akademik në vend.

Besoj se të gjithë ndajmë të njëjtin mendim se Akademia e Shkencave është institucion pararojë, që duhet të mishërojë fuqinë më të spikatur intelektuale dhe akademike të një vendi dhe si rrjedhojë duhet të përfaqësohet denjësisht nga personalitete që kanë kontribute akademike shumë të vlerësuara në zhvillimin shkencës dhe të kulturës. Pa dyshim ndjehem e vlerësuar që më është besuar nga kolegët mundësia për të prezantuar nismën ligjore, që synon të reformojë institucionin e Akademisë së Shkencave dhe ndiej barrën e madhe të përgjegjësisë, pasi kjo natyrisht nuk mund të jetë përpjekje e një rrethi të ngushtë profesionistësh, përkundrazi, lipset domosdoshmërisht që në këtë debat të përfshihet një rreth sa më i gjerë ligjvënësish dhe personalitetesh me tituj dhe grada shkencore. Ky konsultim dhe ballafaqim duhet të jetë real dhe

i larguar nga këndvështrimet me interesa afatshkurtra, por duke siguruar një vizion dhe model për funksionimin e këtij institucioni elitar. Ne, grupi i deputetëve nismëtarë, kemi propozuar që promovimin e nismës në komisionet parlamentare, krahas shpjegimeve të dhëna në relacion shoqërues, ta bëjmë përmes dhënies së përgjigjeve të disa pyetjeve që mund t'i lindin kujtdo që lexon nismën e propozuar. Së pari, pse ne si deputetë nismëtarë kemi vendosur ta mbështesim propozimin në Kuvend të kësaj nisme. Për këtë projektligj që kemi iniciuar ne, si grup nismëtar, kemi marrë mbështetje dhe asistencë teknike nga grupi i punës, i ngritur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si edhe nga Komisioni *ad hoc*, i ngritur nga asambleja e Akademisë së Shkencave. Drafti i është nënshtruar një procesi konsultimesh me akademikë, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë, qendrave dhe institucioneve kërkimore, të shoqërisë civile, sektorit privat e të tjerë.

Gjithashtu, ai është diskutuar dhe miratuar në parim dhe nën për nën edhe me drejtues dhe përfaqësues të ALEAS, Shoqata e Akademive Europiane, si edhe të Akademisë së Gjermanisë.

Pas diskutimeve të përbashkëta, menduam paraqitjen për shqyrtim të kësaj nisme ligjore për dy arsye kryesore: 1. Për rëndësinë dhe rolin që ka Akademia e Shkencave dhe reformimi i saj, ndaj menduam që procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës, i hapur, transparent dhe Kuvendi është institucioni që mund ta realizojë shumë mirë këtë proces. Së dyti, parlamenti ka disa përvoja të tilla nismash, duke u kthyer në një parlament ose institucion ligjvënës proaktiv, që ka ndërmarrë nisma të tëra prej grupe deputetësh, sidomos kur bëhet fjalë për institucione të pavarura dhe Akademia e Shkencave është një institucion i pavarur.

Pse një ligj i ri për Akademinë e Shkencave? Në fakt, projektligji është hartuar në kuadrin e të gjithë hapave të ndërmarra nga qeveria në fushën e kërkimit shkencor, që përfshin, pa dyshim, edhe reformimin e Akademisë së Shkencave. Kërkesat e qeverisë, komunitetit akademik dhe shkencor të vendit, por edhe interesi publik konvergojnë të gjithë në pikën e përbashkët se Akademia e Shkencave ka nevojë të reformohet, t'iu përgjigjet nevojave dhe realitetit të shoqërisë sonë, por edhe të kërkimit shkencor. Ky proces reformimi kërkon të kemi një akademi sipas modeleve bashkëkohore, konform standardeve të akademive europiane. Duke sjellë një projektligj të ri në Kuvendit për t'u miratuar, mendojmë që kontribuojmë në reformimin e këtij institucioni.

Ky projektligj synon ripërtëritjen e Akademisë së Shkencave, realisht qendra e aktivitetit të Akademisë zhvendoset nga kryesia drejt asamblesë, seksioneve dhe komisioneve. Gjithashtu,

përmes këtij projektligji krijohet hapësira ligjore për krijimin e mundësive kërkimore - shkencore, sipas fushave prioritare të zhvillimit në vend dhe nevojës për t'i paraprirë këtij zhvillimi.

Dua të ndaj disa nga risitë kryesore që projektligji parashikon, si: funksionimin e Akademisë së të Rinjve, si organ këshillues dhe bashkëpunues pranë Akademisë, duke inkurajuar veprimtarinë kërkimore - shkencore të kërkuesve të rinj dhe duke i promovuar ata. Gjithashtu, synohet të ndërtohet një akademi e shkencave e hapur drejt komuniteteve të arsimit të lartë dhe atyre kërkimore. Kjo do të realizohet përmes ndërtimit të komisioneve si njësi permanente të Akademisë në kuadrin e seksioneve dhe të përbëra, përveçse nga anëtarët e Akademisë, edhe nga profesorë dhe ekspertë të kualifikuar me arritje të spikatura në disiplinat përkatëse. Projektligji përcakton dispozita ligjore për garantimin e integritetit të kërkimit shkencor në Shqipëri, jo vetëm në kuadrin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave dhe anëtarëve të saj, por edhe për gjithë sistemin e kërkimit shkencor dhe të institucioneve të arsimit të lartë në vend.

Gjithashtu, projektligji synon edhe krijimin e kushteve ligjore, në mënyrë që funksionimi i Akademisë së Shkencave dhe veprimtaria e saj të hapen dhe të sinkronizohen me veprimtarinë e akademive dhe të akademikëve shqiptarë jashtë vendit. Një dispozitë e veçantë e tij parashikon, që personat me shtetësi shqiptare, që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të ALEAS, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kjo dispozitë do të mundësojë një sinergji të mirë mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtarëve të saj me akademikë shqiptarë në vendet e rajonit, por edhe më gjerë në diasporë.

Grupi i deputetëve nismëtarë është i ndërgjegjshëm se shqyrtimi dhe miratimi i kësaj nisme ligjore, duhet të kalojë nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës në komisionet e Kuvendit, ku një vend të posaçëm duhet të zënë seancat dëgjimore publike me akademikë dhe ish-akademikë, me grupet e interesit, me universitetet dhe me shoqërinë civile, për të tërhequr sa më shumë mendime të vlefshme, që mund të reflektohen në ligj për ta përmirësuar dhe për ta bërë sa më të zbatueshëm.

Ne, grupi i deputetëve nismëtarë, jemi plotësisht të hapur për të pranuar mendime dhe sugjerime për ta pasuruar dhe përmirësuar nismën, duke qenë të bindur se ju, si anëtarë të Komisionit të Edukimit, por edhe të gjithë të ftuarit në seancat e diskutimit të projektligjit, do të kontribuojnë për një ligj më të mirë, më të zbatueshëm dhe që realisht do ta reformojë Akademinë e Shkencave në Shqipëri.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përpos gjithçkaje që parashtrova deri tani, e cila ishte në emër të grupit nismëtar, dëshiroj që para se të fillojë diskutimi në parim, të jap disa komente dhe sugjerime për projektligjin e propozuar. Personalisht, mendoj se Akademia e Shkencave duhet të jetë më miqësore dhe më e hapur ndaj grave dhe ndaj të rinjve, sidomos atyre që janë akademikë dhe që kontribuojnë në fusha të ndryshme të shkencës, si dhe të inkurajojë angazhimin dhe promovimin e tyre.

Meqenëse në projektligj krijohet Akademia e të Rinjve, hapësirat që u krijohen atyre janë disi të kufizuara, prandaj sugjeroj të shihet mundësia për t'u krijuar hapësira më të mëdha dhe mundësi për të konkuruar edhe për poste ekzekutive. Ndërkohë, për promovimin dhe përfshirjen e grave shkencëtare apo të atyre që kontribuojnë në fushën e shkencës pranë Akademisë së Shkencave, ju sugjeroj të shohim mundësinë për ta mirëpërcaktuar në projektligj.

Ndoshta do të ishte e dobishme të përcaktohej në këtë projektligj në mënyrë më eksplicite edhe përfshirja më efektive e Akademisë së Shkencave në proceset e dhënies së titujve shkencorë; theksoj se këto janë sugjerimet e mia personale. Autoriteti i saj akademik duhet të jetë garanti i vlerësimit objektiv të punimeve shkencore, me të cilat autorët përfitojnë titujt e pretenduar në të gjitha fushat, duke mbështetur veçanërisht ato kërkime që i shërbejnë zhvillimit të vendit apo hartimit të strategjive qeverisëse me fokus afatgjatë.

Në këtë drejtim, roli i Akademisë së Shkencave për të orientuar ose udhëzuar edhe Ministrinë e Arsimit për politika afatgjata të karakterit studimor në fushën e kërkimit shkencor është një burim i domosdoshëm, që garanton zbatimin e metodikave shkencore bashkëkohore. Kësisoj, prezenca edhe në projektligj e autoritetit akademik, në fakt e Akademisë së Shkencave, në institucionet që kryejnë dhe certifikojnë kërkimin shkencor, do të rriste cilësinë, efektivitetin dhe shkallën e aplikimit të këtij të fundit. Madje, dua të theksoj në mënyrë të veçantë rolin e padiskutueshëm dhe të domosdoshëm që Akademia e Shkencave duhet të luajë në studimet e Albanologjisë, në studimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, kontribute me vlerë jo vetëm për ne, por edhe për brezat që vijnë, të cilat janë edhe simbolet e identitetit kombëtar.

Së fundi, edhe Bashkimi European ka sugjeruar në dokumentet e tij ruajtjen e gjuhës dhe të identitetit kombëtar edhe për anëtarët dhe vendet anëtare të Bashkimit European, duke i dhënë një rëndësi të veçantë studimeve të gjuhës dhe të identitetit kombëtar. Domosdoshmëria për reformimin dhe vitalizimin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave, mendoj se duhet të reflektohet jo vetëm me zëvendësimin e anëtarëve dhe vendosjen e kriterëve të moshës apo të

hierarkisë organizative në funksionimin si administratë klasike, por më shumë është e nevojshme të identifikohet mekanizmi që Akademia të jetë sa më aktive në fushën e kërkimit shkencor, sidomos të fushave më prioritare që vendi ka nevojë, ndryshe përpjekja për ta reformuar Akademinë e Shkencave do të ngelet një zgjidhje që rregullon vetëm aspektet e monitorimit dhe të organizimit të mbledhjeve, të cilat, nëse i referohemi edhe përvojës së këtyre viteve, jo gjithmonë kanë qenë produktive.

Shpresoj që sugjerimet e mia personale të merren në konsideratë nga ju, kolegë të nderuar, dhe ju falënderoj shumë për vëmendjen!

Jemi të hapur për pyetje, komente dhe sugjerime.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja Gjermani!

A ka ndonjë nga deputetët nismëtarë të projektligjit për të shtuar ndonjë gjë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk ka.

Përpara se të hapim diskutimin në parim të projektligjit, a ka ndonjë që do ta marrë fjalën?

Nuk ka.

Vijojmë me diskutimin në parim të projektligjit.

Keni ndonjë gjë për të thënë?

Zonja Ekonomi e ka fjalën.

Milva Ekonomi – A mund t’ju ndihmoj me diçka?

Së pari, ne kemi thirrur këtu edhe dy grupe të tjera, me përfaqësues që vijnë nga grupi i punës, i cili ka hartuar këtë projektligj, përfaqësues nga Akademia e Shkencave, si dhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit, e cila do të marrë një moment të veçantë në punën e komisionit, për të reflektuar në lidhje me të gjitha çështjet që u ngritën këtu. Unë do t’ju sugjeroja që ta merrnin fjalën përfaqësuesit e këtyre dy grupeve, që kanë ardhur për të na paraqitur projektligjin, punonjësit e grupit të punës, si dhe ata që kanë qenë pjesëmarrës të këtij grupi pune në Akademinë e Shkencave.

Së dyti, dua t’ju bëj me dije që komisioni, ndërkohë ka bërë një punë përgatitore, ka caktuar një relator për këtë projektligj, i cili është zoti Ismet Beqiraj.

Së treti, përpara se të kalojmë në diskutimet në parim, duhet të ketë pyetje që duhen bërë nga ana e përfaqësuesve që janë të pranishëm këtu.

Gjithashtu, dua t'ju bëj edhe një sugjerim, duke e nisur me zonjën Gjermani, por edhe me të gjithë ata që kanë pyetje dhe përgjigje, si dhe për nismëtarët që çdo gjë që ata e konsiderojnë të nevojshme, ta dërgojnë me shkrim pranë sekretarisë së komisionit. Do t'ju lutesha të gjithëve që ta kenë parasysh këtë këshillë, pasi në këtë mënyrë ne mbledhim të gjitha shqetësimet që ka për projektligjin dhe do t'i kemi parasysh kur të kalojmë në diskutime më të thelluara, sidomos në diskutimin nën për nën apo në tërësi.

Ju lutem, jepuni fjalën ekspertëve, zotit Gjinushi apo ndonjë pjesëtar tjetër nga Akademia e Shkencave, që dëshiron ta marrë fjalën!

Fatjona Dhimitri – Zoti Gjinushi, fjala për ju.

Skënder Gjinushi – Faleminderit!

Unë do të përpiqem të shtoj pak gjëra, pasi zonja Gjermani parashtroi gjithçka që ishte e nevojshme, për të treguar se përse është ndërmarrë kjo iniciativë dhe cilat janë përparësitë apo përmirësimet që sjell ky projektligj. Megjithatë, dua të shtoj që, ashtu edhe siç dihet, presioni për një reformim të Akademisë së Shkencave ka qenë një presion i mbarë opinionit publik, ka qenë një presion i qeverisë shqiptare, e cila me të drejtë vazhdimisht ka shtyrë në ndërmarrjen e një reforme, por kjo reformë kërkohej, pasi edhe vetë kërkimi shkencor në vend është para një reformimi thelbësor të tijin.

Nuk po u hyj arsyeve pse kërkimi në tërësi ka kaluar mjaft faza të vështira dhe tranzitore, por tashmë, meqë jemi në periudhën në prag të anëtarësimit në Europë, edhe shkenca duhet të jetë në nivelin dhe në standardet e Bashkimit European. Akademia e Shkencave duhet reformuar edhe për faktin se duhet përcaktuar se cili do të jetë pozicioni i saj në këtë piramidë të kërkimit shkencor dhe cili duhet të jetë roli i saj për të qenë shtytësja kryesore dhe në pararojë të reformimit të vetë kërkimit shkencor në vend.

Debati ka qenë në dy drejtime.

E para, ka qenë deri në ekstrem debati nëse duhej justifikuar një Akademi e Shkencave në kushtet e Shqipërisë.

E dyta, një akademi me institute, pra të ketë edhe një rol aktiv në kërkim apo një akademi thjesht onorifike, siç u tentua të bëhej në vitin 2008.

Grupi hartues i projektligjit kishte si detyrë kryesore pikërisht zgjidhjen e këtyre dy çështjeve themelore, ku së parës iu dha një përgjigje pozitive, që Akademia e Shkencave ka kryer një mision të pazëvendësueshëm ndër vite dhe duhet, pavarësisht problemeve që ka kaluar dhe po

kalon, të riorganizohet dhe të reformohet për të rigjetur reputacionin dhe pozicionin e saj më të mirë.

E dyta, sa i takon debatit për një akademi me institute dhe pa institute, vlerësojmë që akademia e vërtetë është një institucion ku kanë nderin të përfshihen ata që fitojnë titullin akademik dhe duhet të jenë, siç tha edhe zonja Gjermani, ndër përfaqësuesit më dinjitozë dhe aktivë në fushën e shkencës apo të krijimtarisë. Sigurisht, Akademia nuk duhet të përjashtohet edhe nga roli aktiv nxitës në zhvillimin e shkencës, pra jo vetëm nëpërmjet anëtarëve të saj, të cilët punojnë individualisht në sektorë të caktuar, por edhe si institucion.

Pikërisht për këtë arsye lihet e hapur në këtë projektligj, pra jepet një zgjidhje kompromisi e tillë që Akademia e Shkencave të ketë të drejtën të ngrerë edhe qendra të kërkim-studimit afatshkurtër apo afatgjatë, që ngrihen sipas nevojës, sipas detyrës që merr dhe sipas detyrave që i jep qeveria apo shoqëria. Është pikërisht ai merak që paraqiti edhe zonja Gjermani, që Akademia duhet të ketë edhe një rol nxitës dhe të jetë pjesëtare në ringritjen e kërkimit në fusha të caktuara dhe patjetër Akademia duhet të ketë edhe një rol të veçantë në fushën e albanologjisë.

Një arsye tjetër pse u ndërmor kjo reformë dhe duhej rishqyrtuar i gjithë ligji, është sepse në periudhën 2007-2008 Akademia kaloi një proces reformimi që rezultoi i dështuar, duke lënë dy pasoja: së pari, e ktheu Akademinë në institucion të atrofizuar, në aspektin që e shkëputi nga kërkimi shkencor, de fakto, dhe, së dyti, krijoi një amulli në anëtarësinë e Akademisë deri me përmbajtje antikushtetuese. Pra, ligji në fuqi ka nën antikushtetues të rrëzuar, madje nga Gjykata Kushtetuese ka dalë një vendim që nuk ishte zbatuar deri para një viti. Kështu që projektligji i ri vlerësojmë se i realizon këto detyra apo përcaktime që përmenda, prandaj edhe është rishkruar projektligji, sepse ripërcaktohet më qartë misioni i Akademisë, detyrat e akademikëve dhe rregullohet anëtarësia e Akademisë. Anëtari korrespondent është pikërisht ai që mungonte në ligjin e mëparshëm, kur e dimë shumë mirë që tashmë ka shumë individë me origjinë dhe shtetësi shqiptare, të cilët kanë një kontribut të shquar në shkencë dhe nuk mund të jenë anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave, pra ky status nuk ekziston; përfshihemi dhe hapemi ndaj Diasporës, ndaj kontribuesve që punojnë jashtë vendit, bëhet një hapje edhe ndaj institucioneve kërkimore në vend, siç e tha edhe zonja Gjermani, pra në komisionet e Akademisë tashmë përfshihen edhe jo anëtarë të saj, ashtu siç për herë të parë futet në ligj Akademia e të Rinjve, deri tani e rregulluar me akte nënligjore dhe jo me një akt ligjor, çka u jep atyre një fuqi më të madhe, ligjshmëri dhe aktivizim më të madh pranë Akademisë. Në ligj parashikohet që Akademia e të Rinjve të

përfaqësohet deri në asamble, në mbledhjet vjetore të saj, ku miratohen strategjitë dhe politikat e Akademisë së Shkencave.

Ligji tashmë përputhet me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ku i jepet shumë rëndësi pranimi në Akademinë e Shkencave. Ky s'duhet të jetë më atribut vetëm i asamblesë, e cila sanksionon anëtarësinë, por anëtar akademie nuk bëhesh nga Akademia e Shkencave, por bëhesh nga aktiviteti yt pranë instituteve e shkollave të larta, ku ushtron aktivitetin pedagogjiko-shkencor. Akademia e Shkencave është ajo që, së fundi, në bazë të kriterëve të procedurave tepër rigoroze, duhet të zgjedhë midis më të mirëve, ata që në Akademi do të përfaqësojnë vlerat më të mira të fushave të caktuara. Kësaj i jepet shumë rëndësi, por, sigurisht, kriteret e procedurave janë pjesë të statutit, sepse, kuptohet, asnjë ligj i Akademisë së Shkencave nuk merr përsipër të hyjë në detaje.

Thamë se riformulohet vetë modeli i Akademisë, pra është vërtet një akademi me një asamble që ka rol promovues, por pranë saj mund të ngrihen edhe njësitë e kërkimit dhe të sigurohet një rifreskim i saj, pa përdorur metoda anti-kushtetuese dhe spastrimi, që synojnë joreformim të akademisë, por spastrime me emra. Ne kemi marrë një model të gjithëpranuar tashmë, 1/3 e akademive europiane kanë kriter që mbi një moshë të caktuar, titulli i akademikut dhe të drejtat e tij janë të paprekshme, por nuk përfshihet në numrin e anëtarëve të rregullt, që quhet ose aktiv. Pikërisht kjo bën që të mundësohet harmonizimi midis brezave apo rifreskimi i Akademisë së Shkencave, pa krijuar situata diskriminuese për çështje moshe.

Projektligji i jep rëndësi edhe marrëdhëniet e Akademisë me qeverinë dhe Kuvendin, veçanërisht me komisionin përkatës në Kuvend, sepse Akademia e Shkencave, si një organ këshillimor ka nevojë të dëgjohet, por duhet, gjithashtu, të ketë një urë bashkëpunimi me qeverinë dhe Kuvendin.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Ju falënderoj, zoti Gjiniushi!

Nga Akademia Kombëtare Gjermane, zoti Lucjan Brujan.

Dëshironi të shtoni diçka?

Lucjan Brujan – Mirëmëngjesi!

Faleminderit për ftesën, zonja dhe zotërinj deputetë!

Unë përfaqësoj Akademinë Gjermane të Shkencave dhe pjesën e procesit të Berlinit, që merret me pjesën shkencore.

Dëshiroj të them që kemi bashkëpunuar për një periudhë kohe me Akademinë e Shkencave shqiptare për ta reformuar dhe modernizuar nëpërmjet këtij projektligji.

E bëjmë këtë për të mbështetur kolegët tanë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, si dhe për zhvillimin e saj, gjithashtu edhe për të mbështetur akademikët shqiptarë të Diasporës.

Nuk dua të flas shumë, pasi zonja Gjermani i tha të gjitha gjërat, për të cilat edhe unë jam dakord, por dua t'ju them se kur filluam punën për këtë projektligj, nuk jemi mbështetur në parimin *copy-paste*, sepse nuk është ide e mirë të kopjojmë modelet që funksionojnë në vendin tonë, me shpresën që ato do të funksionojnë edhe këtu. Jemi përpjekur të gjejmë një model që është i përshtatshëm për sistemin shkencor dhe arsimor në Shqipëri.

Për këtë morëm në konsideratë tri aspekte: standardet, parimet dhe modelet. Ajo që duhet të bëjmë është që të jemi në përputhje me standardet europiane, duke u përpjekur të kemi një konvergjencë, duke ecur hap pas hapi për t'u përshtatur me standardet europiane.

Së dyti, ishin parimet. Parimet e Akademisë së Shkencave njihen botërisht dhe dy nga këto parime kryesore janë: cilësia shkencore dhe liria shkencore, që do të thotë “autonomi”.

Një parim tjetër i rëndësishëm, të cilin e përmendi edhe zonja Gjermani, është të qenurit të hapur, pra hapja e shkencës ndaj njësive të tjera shkencore dhe arsimore, ndaj universiteteve, ndaj grave dhe ndaj të rinjve.

Për sa u përket modeleve, ne kemi ndjekur tendencën që ka ALEA, që është shoqata e të gjitha akademive shkencore; jemi përpjekur të përshtatim tendencat e reja në këtë fushë me akademitë e tjera europiane. Këtu do të përmend Akademinë e të Rinjve dhe Këshillimit Shkencor, pra dhënien e opinionëve nga ana e Akademisë në lidhje me çështje të rëndësishme kombëtare për ligje dhe strategji. Gjithashtu, flitet për mënyrën se si do ta përfshijmë Akademinë e Shkencave në diplomacinë shkencore, duke krijuar marrëdhënie më të mira ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe shtetit. Gjithashtu, me anë të këtij projektligji ne përpiqemi të krijojmë fleksibilitete, në rastet kur do të krijohen njësitë e reja kërkimore, të cilat shërbejnë për të reaguar shumë shpejt për çështje me rëndësi në vend.

Për ta përfunduar fjalën time, dua t'ju siguroj që ky projektligj është vetëm fillimi, dhe, në kuadër të Procesit të Berlinit, dëshirojmë që ky projektligj të sigurojë një funksionim të plotë të Akademisë së Shkencave. Unë jam i vetëdijshëm se ky është hapi i parë. Ne do të vazhdojmë ta reformojmë Akademinë e Shkencave hap pas hapi, duke synuar që të sjellim shkencën dhe shkencëtarët më pranë homologëve, BE-së.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Brujan!

Vijojmë me pyetjet dhe diskutimet lidhur me projektligjin “Për Akademinë e Shkencave”. Kush e do fjalën?

Fidel Ylli – Unë kisha më shumë një sugjerim se sa pyetje për projektligjin, sepse në 10 vjet si deputet në këtë komision kemi dëgjuar shpesh për nevojën e një reforme në Akademinë e Shkencave dhe është bërë mirë, por gjithmonë kanë qenë kërkesa për një buxhet më të madh, si dhe problemi i godinës. Unë mendoj se reforma duhet të fillojë këtu që t’i japim fytyrën e duhur shtetit shqiptar. Akademia e Shkencave për ne është një institucion shumë i rëndësishëm dhe duhet që me ato para, me të cilat paguhet qiraja e godinës, shteti të merrte përsipër të ndërtonte një godinë serioze për akademikët shqiptarë. Buxheti i Akademisë së Shkencave duhet të jetë një kërkesë primare, ndoshta jo e këtij projektligji, por të jetë në fokus të qeverisë për të rritur buxhetet për kërkimin shkencor dhe për të gjitha vlerat që kanë fushat e ndryshme në vendin tonë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Ylli!

Fjalën e ka zoti Redi Shtino, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Redi Shtino – Dua të bëj një ndërhyrje të shkurtër vetëm për të kontekstualizuar të gjitha sa u diskutuan deri tani për reformën e Akademisë së Shkencave. Kjo sipërmarrje filloi në pranverën e vitit 2016, fill pas miratimit të ligjit të ri të arsimit të lartë. Me një iniciativë të Ministrisë së Arsimit dhe të Kryeministrit gjatë muajve prill –maj u zhvilluan dy takime në Kryeministri me Kryeministrin Rama. Nga këto takime filloi i gjithë rrugëtimi për reformimin e sistemit të shkencës. Pra, ne jemi në kontekstin e reformimit të sistemit të shkencës dhe jo vetëm të reformës së Akademisë së Shkencës. Me urdhrat nr. 296, nr. 297 dhe nr. 298 të ish-ministres Nikolla janë ngritur 3 grupe pune në datën 1 qershor të vitit 2016, që kishin për detyrë realizimin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2017-2022, përgatitjen e dokumentit politik për reformën e sistemit në shkencë dhe ligjit të ri për shkencën. Ndërkohë që strategjia 2017-2022 është miratuar tashmë dhe për të u realizua një census në nivel kombëtar, për herë të parë në vend, që arriti të identifikonte “plakjen” e kërkimit shkencor në fusha të caktuara, ndarjen sipas gjinive, titujve, gradave, kapaciteteve në nivele burimesh njerëzore dhe materialeve, bibliotekave, arkivave e nënteksteve akademike dhe botimeve shkencore. Pra, pasi u mbyll i gjithë

ky proces, u vijua me përpunimin e dokumentit të reformës së sistemit shkencor dhe ligjit për shkencën.

Ligji i shkencës ka përfunduar që prej shkurtit të vitit 2018 dhe ka mbetur në pritje të ligjit të Akademisë, në mënyrë që të paraqiteshin paralelisht pranë komisionit. Ky projektligj erdhi më parë në komision dhe neve na u desh që ta vijonim konsultimet. Pra, ajo që dua të them, për të cilën dua të tërheq dhe vëmendjen e komisionit, por edhe të grupit të punës, është se ligji i Akademisë duhet të zhvillohet. Sigurisht, në kontekstin e gjerë të reformimit të sistemit shkencor, kemi një matje reale në terren që është censusi dhe që na nxjerr të gjitha të dhënat, për të cilat duhet të reflektojmë. Pra, në parim është e lehtë të thuash që duam të reformojmë shkencën, por se si do ta reformojmë, me çfarë ambiciesh, me çfarë matjesh, me çfarë drejtimesh, cilat janë kapacitetet që kanë mbetur aktive, cilat janë të amortizuara deri në atë nivel, sa nuk i rikuperon dot më, ku kërkimi shkencor është “plakur” në atë nivel që nuk ka më pasardhës në nivel gradash dhe titujsh akademikë, që mbulojnë katedrat dhe cili do të jetë prioriteti kombëtar në fushën e shkencës? Të gjitha këto diskutime nuk mund të zgjidhen në mënyrë të izoluar me ligjin “Për Akademinë e Shkencave”. Sigurisht, ligji i Akademisë është shumë i rëndësishëm për ta çuar para, por arsyeja kryesore që jemi këtu është që të hapim një debat të gjerë kombëtar, të marrim kontributin e vlefshëm të të gjitha strukturave të përfshira në këtë proces, në mënyrë që të nxjerrim më të mirën. Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Shtino!

Vijojmë me pyetje dhe diskutime për projektligjin.

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Të them të drejtën e vlerësoj seriozitetin me të cilin po diskutohet në këtë mbledhje. Unë bashkohem me mendimin e parafolësve, veçanërisht me mendimin e zëvendësministrit që e preku me pak fjalë, por që, pa një integrim të të gjitha kapaciteteve universitare, përfshirë edhe Akademinë, që ka qenë honorifike, por pothuajse e atrofizuar, nuk mund të realizohet ky synim dhe ky objektiv që kemi.

Është fakt që në këta 30 vjet kemi pasur një humbje të kapaciteteve intelektuale dhe teknologjike në mënyrën më dramatike, në raport me të gjitha vendet e rajonit dhe BE-së. Kjo ka ardhur për shkak se kemi pasur një emigracion intelektual më të lartin në të gjitha vendet e Lindjes, pra 30% deri 40% e intelektualëve janë larguar nga Shqipëria. Pa dyshim, një rol negativ ka luajtur

edhe fakti se ekonomia shqiptare u paralizua së bashku me të gjitha institucionet përkatëse shtetërore, të cilat luanin rol nxitës në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe të teknologjisë.

Së fundi, është kthimi i Akademisë në rolin e saj honorifik. Në mënyrë graduale ajo erdhi duke e humbur atë rol që duhet të luante dhe ne po përpiqemi sot ta ringjallim.

Në kuadër të kësaj që thashë, të emigracionit intelektual dramatik që ka pasur Shqipëria, në këtë ligj duhet të pasqyrohet një nen apo një pikë lidhur me rolin që duhet të ketë Akademia krahas universiteteve. Ndoshta Akademia mund ta luajë më mirë rolin e njohjes, organizimit dhe gjetjes së mekanizmave të këtij kapaciteti intelektual, që sot është i shpërndarë në të gjithë botën. Të mund ta integrojmë dhe ta absorbojmë për rritjen e cilësisë së universiteteve dhe të kërkimit shkencor në Shqipëri. Unë njoh shumë kolegë të mi nga Fakulteti i Shkencave dhe mund të them se mbi 50% e të rinjve në vitet '90 janë larguar. Janë larguar profesorë dhe pedagogë. Kjo, pa dyshim, është reflektuar edhe me rënien e cilësisë, për mendimin tim, jo vetëm në Fakultetin e Shkencave, por në çdo degë të universiteteve.

Ata janë të gatshëm të vijnë të japin leksione të shkurtra, të involvohen, të vijnë me propozime konkrete për projekte. Por, për fat të keq, unë mendoj se për shkak edhe të një lloji refraktariteti, që është gjetur këtu në nivelet drejtuese universitare, ndoshta edhe të ministrive, ka pasur hezitim në krijimin e këtyre bashkëpunimeve, të cilat mund të luanin një rol shumë të madh në zhvillimin dhe promovimin e këtyre bashkëpunimeve, pa dyshim pastaj edhe të produkteve shkencore. Bashkohem me mendimin e zotit Ylli, që në të vërtetë mund të bëjmë një ligj të mirë. Ne vërtet mund të bëjmë një ligj të mirë dhe të përsosur, por nëse nuk i krijojmë hapësira Akademisë së Shkencave që të luajë si simotrat në vendet e Bashkimit Europian, pra pa një buxhet financiar të plotë që është prioritar, ne nuk mund ta rigjallërojmë këtë kapacitet, i cili për mua është në reanimacion. Pra, shteti, krahas buxhetit, duhet të luajë një rol të rëndësishëm në gjetjen e burimeve financiare, duke bashkëpunuar veçanërisht me biznesin.

Akademia e Shkencave në Francë kishte burime financiare nga departamenti i biznesit. Kjo bënte të mundur që ajo të luante rolin e saj në promovimin e të rinjve, në dhënien e bursave për studimet pasuniversitare, postdoktorale e të tjera. Pra, janë shumë mekanizma që do ta ndihmonin Akademinë e Shkencave në Shqipëri të merrte ato tipare që realisht duhet të marrë.

Riaftësimin e quaj shumë të rëndësishme, ndonëse nuk e di se sa do të jemi në gjendje ta bëjmë. Akademia e Shkencave duhet të ketë në strukturën e vet institute që kanë qenë nderi i Shqipërisë në atë kohë kur ato ekzistonin, pra nuk kanë qenë vetëm institutet e Albanologjisë së

Shkencave, por kanë qenë edhe Instituti i Fizikës Bërthamore, i Biologjisë, i Kimisë e të tjera, të cilat kanë luajtur një rol elitar jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në rajon kanë qenë shumë kompetitive, krahasuese dhe me cilësi të lartë.

Unë mendoj se Akademia e Shkencave do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për sfidat që po has sot shoqëria shqiptare. Këto sfida janë të shumta, sepse nuk janë lokale, por edhe globale për shqyrtimin e temave të tilla. Për shembull, çfarë po ndodh me rininë shqiptare? Pse të rinjtë kërkojnë të largohen nga Shqipëria dhe të kryejnë studimet jashtë Shqipërisë? Gjithashtu, në lidhje me raportin e inteligjencës artificiale dhe shoqërisë në përgjithësi; rolin e librit dhe internetit e të tjera, pra temat janë të shumta.

Unë mendoj se Akademia e Shkencave së bashku me instrumentet që do të ngrerë, do të ketë si objekt zhvillimin, reflektimin dhe pasqyrimin e këtyre problemeve në shoqërinë shqiptare, sepse janë shumë serioze për shoqërinë tonë dhe për çdo familje.

Me këtë rast dua t'ju falënderoj edhe një herë për materialet që keni sjellë, sepse kanë qenë shumë serioze.

Gjithashtu, falënderoj edhe zotin Muhamet Bela, i cili na ka ndihmuar për të gjykuar me materialet shumë serioze dhe informuese që ka përgatitur.

Ju uroj suksese në këtë rrugëtim!

Fatjona Dhimitri – Ju falënderoj, zoti Baraj!

Vijojmë me diskutime të tjera për projektligjin.

Kush e do fjalën?

Po, zonja Nikolla.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Duke e falënderuar për shtjellimin të gjithë grupin e punës, dua të bëj dy pyetje!

Përveç përcaktimit të misionit, tejkalimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Akademisë së të Rinjve, dua të evidentoni edhe një herë se cilat janë rrisitë e këtij projektligji.

Meqenëse mbetet prioritet reforma në sistemin e shkencës, cili është vendi i Akademisë së Shkencave në raport me Akademinë aktuale në arkitekturën e sistemit të ri të shkencës? Cilat janë rrisitë dhe ku qëndron reformimi i Akademisë së re që sjell ky ligj në raport me Akademinë aktuale të Shkencave?

Fatjona Dhimitri – Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – E falënderoj kolegen time, zonjën Gjermani, profesor Skenderin, zëvendësministrin e Arsimit dhe zotërinë që vjen nga Gjermania! Unë kam disa pyetje. Modestisht, merrini, po të doni, edhe si komente të një njeriu që nuk i ka kuptuar, pasi ka lexuar nëntekstet.

Së pari, bashkohem me pyetjet e koleges Nikolla për të kuptuar realisht cili është ndryshimi i madh.

Zoti Gjinishi, ju me të drejtë folët për atrofizimin dhe bashkohem 100% me ju. Për të qenë e singertë, nga karriera ime akademike e kam përmendur këtë term që në vitin 2006, kur kam filluar edhe vetë të reflektoj për raportin midis Akademisë së Shkencave, universiteteve shqiptare dhe kërkimit shkencor. Duke qenë se nga viti 2006 deri në vitin 2018 ne vazhdojmë të flasim për atrofizim, do të thotë se kemi një problem të madh si shoqëri, si botë kërkimore dhe akademike për ta vënë gishtin në plagë. Me sa duket, na dhemb të gjithëve dhe, nëse dikush e heq gishtin nga plaga, e bën sepse ka frikë të preket vetë. Ky problem shkon përtej kësaj tryeze, përtej këtij viti dhe përtej kësaj qeverisjeje, po të doni, por, me sa duket, deri më sot, nuk ka marrë zgjidhjen e duhur, ndonëse është ngritur zëri nga të gjitha anët.

Dua të sjell në vëmendje faktin që në 3 vjetët e shkuara, pas një nisme historike të qeverisë shqiptare dhe të Ministrisë së Arsimit për një reformë në arsimin e lartë, kemi sot një ligj të arsimit të lartë, i cili, në dijeninë time, qofsha e gabuar, është i vetmi që prek edhe fushën e kërkimit shkencor. E përmenda këtë gjë, sepse projektligji që vjen sot, siç e kuptoj unë, ka të bëjë me rregullimin e një institucioni, por unë nuk e shikoj, mbase nuk jam mjaftueshëm e zonja ta shikoj, lidhjen organike të këtij projektligji me ligjin ekzistues të kërkimit shkencor, i vetmi që ekziston sot, i cili përpiqet të rregullojë kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, ku zhvillohet kërkimi shkencor, të cilat, mirë apo keq, po e bëjnë. Ka shumë defekte dhe mangësi, por ky është një diskutim tjetër. Ne mund të bëjmë një debat tjetër, sepse akoma nuk ka shteruar. Formalisht, nuk pashë një lidhje të këtij projektligji me ligjin e arsimit të lartë për kërkimin shkencor.

E para, duke iu bashkuar pyetjes së zonjës Nikolla, çfarë sjell realisht si reformues në fushën e kërkimit shkencor roli që duhet të luajë akademia e re, që do të rezultojë nga ky projektligj apo nga drafti final, e cila do të dalë mbas debateve që sapo kanë filluar, për të cilën besoj do të vazhdojmë edhe me dëgjesa të tjera?

Kam edhe disa pyetje pas leximit të projektligjit.

Në këndvështrimin tim më rezulton se anëtarët e Asamblesë janë njëkohësisht edhe anëtarë ose punonjës të punësuar pranë komisioneve, sepse në projektligj nuk është e qartë ndarja

mes organit politikbërës, që është Asambleja, dhe organeve ekzekutive. Pra, duket sikur janë të njëjtët, edhe anëtarë të Asamblesë, edhe zbatues. Në këndvështrimin tim, nuk mund të jenë zbatues.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, ka nevojë të qartësohet. Prandaj e bëj në formë pyetje, sepse nuk më rezulton e qartë.

Zonja Gjermani, ju mendoni që në një farë mënyre Akademia të luajë një rol certifikimi, nëse nuk e kam kuptuar gabim, të kërkimit shkencor që zhvillohet edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë. Unë edhe këtu kam një problem, pasi nuk e kuptoj pse duhet të jetë Akademia e fundit që të thotë fjalën për kërkimin shkencor, ndërkohë që ligji i arsimit të lartë shprehet shumë qartë cilat janë proceset, procedurat dhe rruga që ndiqet nga kërkuesit shkencor për të mbërritur. Mendoj të kemi sa më shumë qendra me pavarësinë dhe lirinë e tyre akademike për të thënë dhe fjalën e fundit, si Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik e të tjerë me radhë. Unë nuk e pranoj si parim akademik, sepse më duket se cenon, nëse nuk e kam kuptuar gabim, atë që quhet liria dhe pavarësia akademike e institucioneve, të cilat, me ligjin e arsimit të lartë, kanë tagrin ta kryejnë këtë kërkim shkencor, madje të jenë në garë me njëri-tjetrin, të sfidojnë Akademinë dhe, anasjelltas, edhe Akademia t'i sfidojë ato.

Këto janë një pjesë e pyetjeve, pasi kam edhe të tjera, por po i rezervoj, sepse besoj se shumë prej tyre do të sqarohen në përgjigje dhe avash-avash do të ecim me diskutime të tjera.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Vijojmë me përgjigjet.

Skënder Gjinushi – Faleminderit!

Ky projektligj është për Akademinë e Shkencave ose ndryshe Asambleja. Pra, duhet të jetë e qartë që akademitë përbëhen nga asambleja, e cila është trupa e atyre që kanë fituar titullin akademik dhe, kur kanë institute, përbëhen nga grupi i qendrave të kërkimit që janë pranë saj. Për sa kohë pranë Akademisë së Shkencave nuk ka institute dhe qendra kërkimi, atëherë Asambleja nuk merret vetë me kërkim shkencor. Pra, rrjedhimisht, projektligji merret vetëm me funksionimin, organizimin, rifreskimin dhe riorganizimin e Asamblesë. Sigurisht, në këtë drejtim bëhet me ligj maksimumi i mundshëm çfarë mund t'i rifreskosh një asambleje, sepse, siç dihet, titujt akademikë,

si çdo titull, merren dhe nuk dorëzohen më, përveç shkaqeve madhore. Ne e përmendëm edhe më parë që gjithçka e mundur rregullohet, sepse, së pari, statusi akademik, meqenëse deri tani kemi të bëjmë me një akademi pa qendra kërkimi, pa njësi kërkimi dhe studimi, në letër është i përcaktuar që ka rolin e këshillimit, por duhet të përcaktohet se si e ushtron këtë rol pa ngritur instrumente ndihmës. Ligji jep mundësinë që Akademia të ngrejë edhe njësitë e kërkimit, të studimit, të oponencës dhe të promovimit. Ky është një ndryshim i madh në ligj, por zbatimi i tij varet nga financimi, nga vetë kapacitetet e Akademisë, nga cilësia e të tjerë, si për çdo ligj që nuk rregullon gjendjen, por varet nga shkalla e zbatimit të tij.

Së dyti, duke qenë një ligj kryesisht për asamblenë, atëherë ky i rregullon të gjitha marrëdhëniet e asamblesë. Ligji në fuqi, absolutisht, kishte një turbullirë për sa i takon anëtarësimit. Aty përmendet edhe termi “anëtarë të përjetshëm”, kur ndërkohë titulli, në të gjitha ligjet e akademive, është i përjetshëm dhe nuk flitej për anëtarin korrespondent, pa hyrë te shkeljet kushtetuese e me radhë.

Ky projektligj i ri sjellë një frymë të re. Ashtu siç e theksoi zoti Baraj, një nga problemet tona është ikja e trurit, pra, ajo pjesë e shoqërisë shqiptare, e inteligjencës që është larguar, të cilët mund të bëhen aktivë në Shqipëri, të kontribuojnë pranë Akademisë, ku mund të futet anëtari korrespondent, i cili mund të jetë formalisht, por duhet të ftohet një herë ose dy herë në vit për të kontribuar në nxitjen dhe hapjen e sektorëve të rinj, ata sektorë që mund të jenë plakur e me radhë. Pra, kontributin e tyre ta japin pranë Akademisë së Shkencave, pranë shkollave të larta e të tjerë.

Patjetër që futja e Akademisë së të Rinjve është, gjithashtu, një instrument shumë i rëndësishëm, sepse lidh Akademinë e Shkencave edhe me pjesën më aktive të kërkimit, që janë kërkuesit e rinj. Ashtu siç u sugjerua, mendoj që të ketë një hapje më të mirë edhe ndaj grave ose një barazi gjinore më të mirë. Asambleja organizohet në seksione dhe komisione. Pra, anëtarët e Asamblesë nuk e ushtrojnë aktivitetin në mbledhjet vjetore, që janë një herë ose dy herë në vit, por e organizojnë në seksione dhe komisione. Ligji lejon që në komisione të jenë anëtarë dhe jo akademikë. Akademia nuk është një institucion shumë ekzekutiv. Ju kujtoj se asambleja është kryesisht një organ këshillimor kolegial për strategjinë e shkencës, për zhvillimin e shkencës, për promovime, për botime, për dhënie çmimesh, për organizim kongresesh dhe konferencash, të cilën e bën nëpërmjet seksioneve dhe nëpërmjet komisioneve. Është hera e parë që komisionet vihen në ligj, sepse është mirë që puna e akademikëve të jetë në sektorë të të njëjtës natyrë, të mos jenë

heterogjenë dhe t'i bëjë ata më komunikativë dhe efektivë. Futja e anëtarëve të jashtëm patjetër që bën një hapje të Akademisë së Shkencave.

Rifreskimi i Akademisë së Shkencave do të thotë të bëhet vetëm nëpërmjet pranimeve të reja. Pra, është ajo që ne duhet të ndryshojmë.

Me anë të këtij ligji në Akademinë e Shkencave hapen 15 vende të reja për pranime dhe bëhet e mundur që këto pranime të jenë vërtet dinjitoze dhe përfaqësuese. Kjo duhet të jetë jo vetëm një stimul për kërkuesit e rinj, por edhe dhënie e një fryme të re, një fytyrë të re dhe imazhi të ri të Akademisë së Shkencave. Për herë të parë kjo bëhet me ligj të rregullt, brenda normave kushtetuese, brenda lirive akademike dhe nuk bëhet si në vitet 2007-2008, kur pranimet e reja bëheshin me komision qeveritar dhe jo nga vetë Akademia e Shkencave. Ky është një ndryshim thelbësor midis dy reformave: antireformës së vitit 2008 dhe reformës që ndërmerret tani.

Zonja Gjermani e sqaron vetë, por dua të shtoj diçka: ideja e certifikimit të kërkimit, të titujve dhe gradave që jepen, nuk do të thotë se Akademia vihet mbi të tjerët, por një ndër misionet që u jepen akademike është se shprehen pranë qeverisë, pranë organeve përkatëse për nivelin e doktoraturave të vlerësimit, nëse janë në drejtimin e duhur, në nivelin e duhur, por nuk merren nëse e meritojnë apo nuk e meritojnë individë të veçantë. Pra, siç shprehesh për nivelin e shkencës, nivelin e kërkimit, pra bëhet një monitorim, patjetër që shprehesh edhe për nivelin dhe cilësinë e titujve dhe gradave që jepen, por këtu nuk ka të bëjë me represione individuale dhe marrje kompetence, sepse tituj gradash japin ata që parashikon ligji.

Pozicioni, bashkëpunimi i Akademisë me institucionet e tjera dhe roli që ajo duhet të luajë në shkencën në tërësi, rregullohen te ligji i shkencës. Pra, me bërjen e ligjit të ri të shkencës, patjetër që duhet harmonizuar projektligji i Akademisë me projektligjin e shkencës për të vendosur qartazi se si Akademia luan rolin e saj në hartimin e strategjive të zhvillimit të shkencës apo në aspekte të tjera të monitorimit të kërkimit. Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Dua vetëm të ritheksoj se ideja e sotme ishte që, në emër të grupit nismëtar, të prezantoja projektligjin dhe, përveç kësaj, rëndësinë e faktit se vërtet projektligji synon të reformojë Akademinë e Shkencave, por, së pari, ta bëjë të funksionojë. Ajo është e atrofizuar. Po flasim të gjithë që jemi në një situatë, gati alarmante, në kuptimin që ka nevojë për një projektligj.

Ne si grup kemi marrë këtë nismë të asistuar nga grupet e punës, të cilët kanë kontribuar shumë në hartimin e këtij projektligji, për ta përcjellë këtu, pikërisht për ta përmirësuar, për ta bërë sa më funksionale, sa më të zbatueshme dhe për ta përballur me të gjitha diskutimet dhe debatet me grupet e interesit, me akademikë dhe ish-akademikë. Kjo nismë është ndërmarrë pikërisht për ta hapur këtë proces, për ta bërë gjithëpërfshirës dhe për ta përmirësuar këtë projektligj.

Nga ana tjetër, në lidhje me sugjerimin tim personal, në fakt, ashtu siç m'u kërkua nga zonja Ekonomi, patjetër që do ta sjell me shkrim dhe do të diskutohet nen për nen kur ta sjell në formën e duhur ligjore, për ta konverguar me ligjin "Për arsimin e lartë", ndoshta edhe me projektligjin për shkencën, që po hartohet nga Ministria e Arsimit. Por, dua të theksoj se ideja dhe sugjerimi im ishte që Akademia të mos jetë vetëm honorifike, pa dyshim të mos përjashtojë askënd, por të kontribuojë në nivelin e kërkimit shkencor në Shqipëri, pa dyshim edhe universitetet sipas ligjit "Për arsimin e lartë". Kjo çështje është diskutuar dhe debatuar shumë së fundi. Unë e konsideroj Akademinë proaktive në këtë vlerësim dhe certifikim, por jo si ndërmarrëse e rolit kryesor. Kështu që në momentin që do ta depozitoj, do të jetë në formën ligjore, sipas strukturës së projektligjit dhe në nenin e duhur. Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – Faleminderit, zonja Gjermani!

Urdhëroni, zoti Shtino!

Redi Shtino – Faleminderit!

Faleminderit që qëndruat te ky argument, sepse ky është shqetësimi më i madh që kemi! Domethënë, koha që u mor për përgatitjen e projektligjit të Akademisë, për shkak të nevojës dhe urgjencës, në vlerësimin tim, ishte shumë e shkurtër, pra nga janari deri në mars. Për këtë arsye rekomandojmë që të kihen parasysh të gjitha gjetjet e censusit të kërkimit shkencor, të kihen parasysh të gjitha analizat që janë bërë te ligji i vjetër i kërkimit shkencor të vitit '94 dhe për këtë ftoj kryesinë të shpërndajë materialet që kemi sjellë për ju, në mënyrë që të jenë të konsultuara nga grupi i punës dhe nga komisioni dhe të shërbejnë për misionin e tyre.

Faleminderit!

Fajtona Dhimitri – Faleminderit, zoti Shtino!

Fjalën e ka relatori i projektligjit, zoti Ismet Beqiraj.

Ismet Beqiraj - Faleminderit!

Përshëndetje anëtarëve, relatorëve dhe të ftuarve për diskutimin e këtij projektligji të rëndësishëm.

Unë sot jam i emocionuar, sepse kam ditëlindjen dhe sigurisht jam me fat jo vetëm që jam pjesë akademike dhe pedagog, por që rilind edhe ligji i ri i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Duke i falënderuar kolegët për mesazhet dhe duke respektuar edhe këshillën e Bujarit, edhe pse isha përgatitur gjatë për të prezantuar një pjesë të risive, më dukej sikur po bëhesha pjesë e grupit nismëtar. Sqarimet që bëri zonja Gjermani, zoti Gjinushi dhe pjesa tjetër ishin sqarime shteruese. Kjo ishte një ditë e gëzuar për të gjithë botën akademike, jo vetëm për institucionin e Akademisë së Shkencave.

Nga leximi dhe krahasimi që i kam bërë projektligjit, duke iu referuar edhe pyetjes së drejtë që bëri kolegja, zonja Nikolla, se çfarë risie sjell ky projektligj, duke e krahasuar me ligjin ekzistues në fuqi nr. 9655, datë 11.12.2006, unë dua të përmend dy-tre risi të këtij projektligji, në mënyrë që opinionbërësit jo vetëm ta vlerësojnë dhe të bëjnë sugjerime, por të mos hedhin baltë mbi gjërat e mira që po bëhen në këtë vend, ku projektligji për Akademinë e Shkencave, që ne po diskutojmë, është një pjesë e rëndësishme e korpusit të madh të reformave, të cilat janë ndërmarrë nga kjo maxhorancë në këtë dekadë.

Ky projektligj vjen si qershia mbi tortë edhe për një sërë ligjesh të tjera, që kanë të bëjnë me arsimin, shkencën dhe kulturën, ku unë dua të fokusohem te ligji “Për arsimin parauniversitar”, te ligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, në veçanti, si dhe te ligji “Për trashëgiminë kulturore e muzetë”, i cili i kapërcen shpeshherë kufijtë e një ligji. Këto ligje jo vetëm që janë të përafruara, por reflektojnë standardet më të mira të BE-së.

Së dyti, reformimi dhe ripërtëritja e Akademisë së Shkencave ka ardhur si nevojë dhe domosdoshmëri. Ky institucion i rëndësishëm duhet të jetë avangardë dhe të impaktojë sinergji e ndikim në thellimin e reformave, që kanë përfshirë të gjithë jetën sociale dhe ekonomike në vend në shumë fusha. Në fokus edhe kjo reformë është e veçantë, sepse e rizgjon këtë institucion nga letargjia e gjatë që e ka mbërthyer. Kur unë krahasoj ligjin, i cili ka 13 vjet në fuqi, me projektligjin e ri, them se u kemi rënë në qafë politikanëve kur kanë diskutuar për Akademinë, pasi i kanë pasur duart e lidhura juridikisht.

Unë dua të përmend disa risi të këtij projektligji, që më tërhoqën vëmendjen. Risia e parë që do të veçoja ka të bëjë me përbërjen e Akademisë, ku, përveç seksioneve dhe komisioneve, janë edhe njësitë e kërkimit të studimit, të cilat, kur ka nevojë në fusha të caktuara, që i kërkon zhvillimi në vend, janë me afat deri në dy vjet, ndërsa ata me afat mbi dy vjet, janë vendimmarrje qeveritare të këtyre institucioneve.

Pse kanë rëndësi këto njësi të kërkimit shkencor?! Me miratimin e ligjit të Akademisë së Shkencave në vitin 2006 u mbyllën dhe u shkatërruan shumë institute shkencore. Unë i bashkohem mendimit të kolegut, zotit Baraj, për institucionet që ai përmendi, por një nga atentatet që i është bërë shkencës dhe kërkimit shkencor janë institutet e burimeve natyrore dhe pasurive natyrore të vendit, ku unë dua të ndalem tek instituti i naftës, i cili ngriti dhe krijoi shkencën e naftës. Pra, kjo do të thotë se këto njësi të kërkimit shkencor duhet të ringrihen mbi bazën e organizimit dhe funksionimit të një ligji modern, i cili është i domosdoshëm edhe për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Së treti, pjesë përbërëse e Akademisë është edhe Akademia e të Rinjve. Kjo është risi, sepse unë e cilësoj Akademinë e të Rinjve si një fidanishte, ku përgatiten asistentët, akademikët e ardhshëm dhe shkencëtarët e ardhshëm të Shqipërisë.

Risi tjetër është reformimi i këtij institucioni, i cili e çon Akademinë e Shkencave në pozicionin elitar që i takon veprimtarisë shkencore, mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës kombëtare të vendit tonë.

Risi tjetër, që është shumë e rëndësishme, është fakti që largon duart nga politika për emërimet, shkarkime, pushtet pa kufi dhe pa mandate, duke e zgjeruar bazën demokratike të organizimit dhe funksionimit deri në kufizim të mandateve të të zgjedhurve. Kjo është risi që duhet vlerësuar.

Hemorragjia e botës akademike, e studiuesve dhe e shkencëtarëve është evidente dhe nuk kemi pse të mos e pranojmë, por hartuesit e këtij projektligji parashikojnë integrimin e plotë të kontributeve dhe vlerave akademike e shkencore jashtë vendit.

Nga ana tjetër, çelësi i zhvillimit të këtij institucioni janë financat. Në projektligj ju parashikoni një nen, për të cilin unë kam një sugjerim, sepse nuk është i qartë dhe ka ardhur momenti që ta ringremë ashtu sikurse është edhe “Pakti për universitetin”, i cili shoqërohet me një buxhet financiar. Unë nuk jam dakord që ju në relacion të thoni se ky projektligj nuk ka efekte financiare. Reformimi patjetër që duhet të ketë edhe efekte financiare, sepse të gjitha këto që themi nuk bëhen pa mbështetje financiare, përveç vetëfinancimeve të ndryshme, të cilat realizohen me projekte dhe detyra të tjera që parashikohen këtu. Unë propozoj që te neni që ka të bëjë me pagën e drejtuesve të Akademisë së Shkencave, të shtohet një paketë ose program financiar për ripërtëritjen e Akademisë së Shkencave.

Për ta mbyllur, dua të them se ky projektligj karakterizohet edhe nga një terminologji e thjeshtë, që më bëri përshtypje, e krasitur nga ujërat e tepërta, koncize dhe të ëmbla gjuhësore, ku unë dua të them se është gjuhë akademikësh. Më ka pëlqyer shumë gjuha e përdorur, përveç dy - tri gjërave, ku përmendni termin “kancelar” më poshtë thoni “administrator” dhe në fund fare: “Me shfuqizimin e ligjit të vitit 2014”, nuk duhet, sepse e ka shfuqizuar ligji i vitit 2006, por që do t’i diskutojmë herën tjetër, nen për nen.

Dua të bëj një kompliment lidhur me këtë projektligj, i cili përshkruhet edhe nga teknikalliteti i saktë juridik. Kjo edhe për meritë të drejtuesit të grupit, zotit Gjinushi, që është nder për ne që e kemi pasur deputet dhe Kryetar Kuvendi.

Ju faleminderit dhe rrugë të mbarë diskutimit dhe miratimit të shpejtë të këtij projektligji!

Fatjona Dhimitri– Faleminderit, zoti Ismet!

Fjala për zonjën Milva Ekonomi.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Fajtona!

Unë dua të shtoj disa gjëra. Ne e dëgjuam që projektligji vjen si nismë e një grupi deputetësh, bazuar në nenin 81 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores, ndërkohë, nisur nga Rregullorja, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, meqenëse është komision përgjegjës, në bazë të neneve 32 deri 38, ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe diskutimin në parim të këtij projektligji. Kjo vjen si një nismë deputetësh, pra nga organe joqeveritare dhe ne bazohemi në Rregulloren e Kuvendit për të zhvilluar dëgjesat.

Deri tani kemi pasur edhe diskutime për masën e financimit të Akademisë së Shkencave.

Para se të kalonim në miratimin në parim të këtij projektligji, do të sugjeroja ta çonim për dhënie mendimi në Këshillin e Ministrave efektin financiar që ka ky projektligj, sepse këtë e kërkon edhe Rregullorja e Kuvendit. Është një detyrim kushtetues, që i lind komisionit.

Komisioni do të vazhdojë punën, ndërkohë që Ministria e Financave dhe Këshilli i Ministrave do të përgjigjen për pjesën e detyrimit financiar që merr propozimi i projektligjit.

Kështu që, të nderuar kolegë të komisionit, mendoj se vendimi i parë që duhet të marrim është kalimi për këshillim i këtij projektligj, si një detyrim kushtetues, në Këshillin e Ministrave dhe në Ministrinë e Financave, që të na japin informacionet e duhura për faturën financiare.

Së dyti, duhet të biem dakord edhe për listën e dëgjesave që kemi hartuar për këtë projektligj. Nuk jeni vetëm ju, si nismëtarë, që shprehni mendimet tuaja për këtë projektligj, por

komisioni ka parashikuar disa dëgjesa me Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, universitetet, si edhe dëgjesa me mendimet ndryshe për këtë reformim.

Komisioni do të marrë kohën e nevojshme për të bërë dëgjesa me grupet e interesit, si dhe me ata që i gjykon të rëndësishëm. Pastaj do të dalë te miratimi në parim, sepse ndërkohë informacioni nga Këshilli i Ministrave do të vijë në diskutimin nen për nen dhe në tërësi.

Nuk e di, të nderuar kolegë, nëse mendoni se ky është propozim i duhur për dëgjesat.

Jeni dakord me këtë kalendar pune?

Besoj se ky është edhe qëndrimi që mban grupi i deputetëve socialistë në komision, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Ju falënderoj, zonja nënkryetare!

E hedhim në votim propozimin e zonjës Milva.

Skënder Gjinushi – Mund të bëj një sqarim vetëm për çështjen financiare?

Milva Ekonomi – Zoti Gjinushi, më falni! Nuk mund të bëni sqarim tani, sepse ky është një proces diskutimi midis anëtarëve të komisionit. Jemi në zbatim të neneve të Rregullores.

Skënder Gjinushi – Sqarimet pranohen në çdo diskutim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri - E hedhim në votim propozimin e zonjës Milva, për kalimin në Këshillin e Ministrave...

Miratohet propozimi.

Të mërkurën, në orën 10:00, fillojnë dëgjesat me Akademinë e Shkencave.

Në orën 12:30 do të ketë dëgjesë me Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Milva Ekonomi – Sipas kalendarit që ne kemi miratuar, në datën 15, ditën e mërkurë, në orën 10:00 është dëgjesa me përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave. Në orën 12:30 është dëgjesa me përfaqësuesit e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe më pas do të vazhdojmë me dëgjesat e tjera, kështu që do të kemi një mbledhje të salla e grupit.

Para se të mbyllim mbledhjen, do t'ju luteshim edhe një herë: vendimet dhe propozimet e projektligjit të depozitohen në sekretari.

Zonja Gjermani, ju lutem; zonja Kumbaro, nëse keni; zoti Bare, nëse ka dhe po ashtu edhe të tjerët, nëse keni propozime, t'i depozitoni në sekretari.

Zoti Shtino u angazhua për informacione.

Do t'ju lutesha shumë të ndahen me komisionin, të gjitha këto do të bëhen pjesë e dosjeve të punës së anëtarëve të komisionit. Ne, ndërkohë, që sot, meqenëse ramë dakord ta dërgojmë mendimin për faturën financiare në Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave për projektligjin, do ta dërgojmë menjëherë.

Fatjona Dhimitri – Të nderuar pjesëmarrës, në përfundim të mbledhjes, lidhur me shprehjen e mendimit opozitar për sa i përket projektligjit për Akademinë e Shkencave, në mbledhjen e ardhshme do të kemi një qëndrim më të detajuar.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

Anëtarët e komisionit, ju lutem, qëndroni pak më gjatë!

MBYLLET MBLEDHJA